

PROGRAMI PËR KONKURUESHMËRINË DHE NOVACIONE (CIP)

Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin komunitar për Konkureshmërinë dhe novacioneve, Competitiveness Innovation Programme, (CIP) për periudhën 2007-2013.

Sipas vendimit të Parlamentit European Nr.1639/2006/EC për fillimin e programit për Konkureshmërinë dhe novacioneve, Competitiveness Innovation Programme, (CIP) për periudhën 2007-2013 është e lejuar që të aplikojë dhe të marrë pjesë edhe Shqipëria.

Brenda programit CIP ka 3 nënprograme (shtylla) kryesore të cilat janë të fokusuar për SME-të dhe për ato lloj teknologji që mbrojnë mjedisin si:

- ❑ **Entrepreneurship and Innovation Programme (EIP).**
- ❑ **ICT policy support programme**
- ❑ **The intelligent energy-europe programme(IEE).**

METE është shprehur dakord për të marrë pjesë në nënprogramin e parë EIP dhe të tretin IEE.

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës z. Genc Ruli dhe nënpresidenti i Komisionit European, Z.Günter Verheugen, me datë 27 qershor 2008, firmosën marrëveshjen e mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Shqipërisë në nënprogramin e parë të Sipërmarrjes dhe Novacionit EIP, të programit për Konkureshmërinë dhe Novacionin CIP.

MoU u ratifikua me Ligjin nr.9984, datë 11.09.2008 “Për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit “Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit, 2007-2013”, i cili u botua në Fletore Zyrtare Nr.143 datë 22 shtator 2008 dhe ka hyrë në fuqi me datë 7 tetor 2008.

Me datë 16 dhjetor 2008 METE ka shlyer gjithashtu pagesën për kontributin financiar për pjesëmarrjen në programin EIP për llogari të EU General Budget, në vlerën prej 36,738 Euro.

Për më tepër informacion rreth programit dhe mënyrën e aplikimi ju lutemi vizitoni:

http://ec.europa.eu/cip/index_en.htm